



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Njoftim për fermerët

Të nderuar fermerë,

Nisur nga ankesat që janë shfaqur herë pas herë në media të ndryshme në lidhje me kriteret e përfitueshmërisë për masën e mbjelljes së grurit e më saktësisht në lidhje me titujt e pronësisë, duhet të keni sa më të qartë që pranohet çdo kontratë qiraje apo çdo dokument i ligjshëm që nënshkruhet ndërmjet palëve, duke përdorur formularin 12 i cili nënshkruhet ndërmjet palëve dhe siglohet në Njësinë Administrative. Gjithashtu janë të pranueshme deklarata noteriale të lëshuara nga qiradhënësi i cili përmend tokat bujqësore sipas dokumenteve të pronësisë që ia lëshon dikujt tjetër.

Nëse mungon harta treguese për AMTP dhe Njësia Vendore nuk e lëshon një kopje tjetër, fermeri mund dhe duhet të informohet që formulari 4 që plotësohet më të dhënat e pasurive bujqësore nga ky titull pronësisë, të firmoset nga punonjësi i ekstensionit bujqësor.

Nëse mungon AMTP (ka humbur), Njësia Administrative lëshon shkresë zyrtare e cila informon se kush fermer është i pajisur me titullin e pronësisë AMTP me të dhënat identike si AMTP që mund të ketë humbur.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është 15 ditë nga njoftimi e-Albania/njoftimi zyrtar nga Agropika.

Faleminderit!